



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 79 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17 pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, dhe nenit 15 pika “d” të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110-391, dt.25.02.2010, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe duke vendosur sipas kërkesës **05 Nr.350/03-180986/25 dt.02.12.2025**, të aplikuesit/pronarit: **Genc Rodiqi**, Johan Gëte, nr.4.Prishtinë, për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ **“Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore”**, me referencë **05 NR. 350/02-133599/24 DT. 02.12.2024**, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 15.01.2026, merr këtë:

V E N D I M

PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR
CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE” 05 NR. 350/02-133599/24 DT. 02.12.2024

I. I VAZHDOHET afati i vlefshmërisë së aktit administrativ **“Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore”**, **05 NR. 350/02-133599/24 DT. 02.12.2024**, i lëshuar nga kjo drejtori, në emër të aplikuesit/pronarit **Genc Rodiqi**, Johan Gëte, nr.4.Prishtinë, për cakmtimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, me etazhitet B+P+1, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.748-34, ZK. Çagllavicë.

II. Afati i vlefshmërisë së aktit administrativ nga paragrafi I. i këtij vendimi, vazhdohet edhe për një (1) vit tjetër, dhe i njëjti do të prodhojë efekte juridike nga dita e njoftimit të palës me këtë akt.

A r s y e t i m

Aplikuesi/pronari **Genc Rodiqi**, Johan Gëte, nr.4.Prishtinë, me **05 Nr.350/03-180986/25 dt.02.12.2025**, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit, vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ **“Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore”**, me referencë **05 NR. 350/02-133599/24 DT. 02.12.2024**.

Me kërkesën 05 Nr.350/03-180986/25 dt.02.12.2025, është prezantuar Vendimi i Kushteve Ndërtimore 05 NR. 350/02-133599/24 DT. 02.12.2024, lëshuar nga kjo drejtori;

Drejtorja e Urbanizmit dhe Mjedisit, pas pranimit të kërkesës për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ **“Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”**, me referencë 05 NR. 350/02-133599/24 DT. 02.12.2024, shqyrtimit të përmbajtjes së saj dhe konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, dhe të dosjes së lëndës/kërkesës 05 Nr. 350/02-133599/24 dt.11.10.2024 në arkivin e drejtorisë, në mënyrë procedurale dhe kronologjike konstatoi si në vijim:

Drejtorja e Urbanizmit dhe Mjedisit, me aktin administrativ **“Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore”**, me referencë 05 NR. 350/02-133599/24 DT. 02.12.2024, i ka caktuar kushtet ndërtimore aplikuesit/pronarit **Genc Rodiqi**, Johan Gëte, nr.4.Prishtinë, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, me etazhitet B+P+1, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.748-34, ZK. Çagllavicë”, konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve.

Sipas paragrafit të parë të pikës "XI", të aktit administrativ "Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore", me referencë 05 NR. 350/02-133599/24 DT. 02.12.2024, thuhet se poseduesi i lejes ndërtimore është i obliguar që, citoj: *"Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë"*.

Bazuar në dosjen e lëndës/kërkesës 05 Nr. 350/02-133599/24 dt.11.10.2024, për caktimin e kushteve të ndërtimit, konstatohet se akti administrativ "Vendimi për caktimin e Kushteve Ndërtimore", me referencë 05 NR. 350/02-133599/24 DT. 02.12.2024, ka filluar prodhimin e pasojës juridike nga data e njoftimit të aplikuesit/pronarit me aktin administrativ, e që është data 17.12.2024, kurse kërkesa për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë është parashtruar me datë 02.12.2025, gjë e cila është në harmoni me afatin, rrethanat dhe pikën 8 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, ku thuhet se, citojmë: *"Kushtet ndërtimore të miratuara nga organi kompetent apo nga veprimi i ligjit, parimi heshtja është pranim do të jenë të vlefshme për një(1) vit, me mundësi vazhdimi për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor"*;

Andaj, bazuar në konstatimet e lartshënuara, dhe në rregullativën ligjore në fuqi, u konstatua se vazhdimi i afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ për lejimin e ndërtimit, është i bazuar dhe ligjor, dhe kjo drejtori të njëjtit vendosi t'ia vazhdojë afatin e vlefshmërisë edhe për një (1) vit tjetër përmes këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror-MMPHI.

Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit/Investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr.350/03-180986/25 dt.02.12.2025 dhe 05 Nr. 350/02-133599/24 dt.11.10.2024.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/03-180986/25 DT. 15.01.2026

Zyrtari,
Anita Osmani



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi